

Dalës-Izlazna

Nr. X-561  
Br.

Data 23 08 2021  
Datum



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ,nr.04/L-032 , Udhëzimin Administrativ të MASHI-it, me nr.22/2013, vendimin nga MASHI nr.01/B ,Nr.1771, datë 06.08.2020, Drejtoria për Arsim, më 23.08.2021, shpall :

**K O N K U R S**

**Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2021-2022 për afatin e gushtit, sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).**

**1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq dhe SHMLP "Isamil Dumoshi" në Obiliq për vitin shkollor 2021-2022 afati i gushtit, mund të konkurrojnë kandidatët , të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës , obligohen t'a bëjnë njohjen e certifikatave ose dëftesave në MASHI, pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

**2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente :

- Fletëparaqitjen, e cila do të merret në shkollën në të cilën konkurron,
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9 )
- Certifikatën e lindjes.

**Sqarim: Shkollat duhet të krijojnë kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë konkurrimit të tyre.**

**3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Dorëzimi i dokumenteve për gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2021/2022 , bëhet me datat: 23.08.2021 – 25.08.2021, në lokalet e shkollës, ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen, duke filluar nga ora 08:00 -16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve do të shpallen në shkollat përkatëse me datën 26.08.2021(në shkollat ku plotësohet numri i nxënësve).

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 30.08.2021.

Kandidati i refuzuar, i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë ankese , brenda 24 orëve , nga koha e shpalljes së rezultateve t`i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit,dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHI-it, te komisioni për ankesa.

#### **4.Kriteret për regjistrim**

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t`i plotësojë këto kriteret :

- 1.Suksesi nga shkollimi i obliguar..... (40%) 40 pikë
  - 2.Suksesi nga lëndët prioritare në test ..... (20%) 20 pikë
  - 3.Numri i pikëve nga testi .....(40%) 40 pikë
- Nxënësi maksimalisht mund t`i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë katër (së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veç e veç , pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve.

#### **5.Renditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

##### **I. Gjimnazi i shkencave të natyrës:**

1. Lënda :Fizikë
2. Lënda :Kimi
3. Lënda:Biologji
4. Lënda :Matematikë

##### **II. Gjimnazi i shkencave shoqëror dhe gjuhësore :**

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjuhë angleze
- 3.Lënda:Histori
- 4.Lënda :Gjeografi

Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkollën profesionale

##### **I.Makineri , Elektroteknikë , Kimi-Teknologji**

1. Lënda :Fizikë
- 2.Lënda :Kimi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK

## II. Ekonomi (banka dhe financa)

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjeografi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK

### • Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1.	Gjimnazi Natyror	2	
2.	Gjimnazi shoqëror	1	33
Gjithsej:		3	12
			45

### • SHMLP “ Ismail Dumoshi“ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Vitet e shkollimit
1.	Elektroteknikë	Telekomunikacion	1	19	2+1
		Informatikë	1	0	2+1
		Energjetikë	2	27	2+1
2.	Makineri	Operator prodhimi	1	12	2+1
3.	Kimi-Teknologji	Laborant i kimisë	1	13	2+1
		Gjeologji	1	23	2+1
4.	Ekonomi	Kontabilitet	1	10	2+1
		Banka dhe financa	1	3	2+1
Gjithsej:			9	107	2+1

Drejtori i DA-së: Rexhep Zeka

